





REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA DRENAS



RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2016 I KRYETARIT TË KOMUNËS



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Zyra e Kryetarit - Në periudhën raportuese janar-qershor të vitit 2016 të kryetarit, janë pranuar 764 kërkesa të ndryshme nga qytetarët të cilave i është përgjigjur dhe ka lëshuar 17 vendime të ndryshme. Zyra e kryetarit ka organizuar një takim me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmuorit të parë të këtij viti, një degjim publik për shpronësimin e pronave dhe tubimin për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Po ashtu është mbajtur një tryezë me qytetarë dhe subjekte tjera për Kornizën Afatmesme buxhetore 2017-2019. Gjithashtu janë mbajtur edhe 3 mbledhje me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe një takim me Inspektoriatin Policorë të Kosovës për të diskutuar sigurinë publike në Drenas. Nënkryetari i Komunës ka mbajtur takime me përfaqësuesit e fshatrave, ku ka marr nga ta kërkesat të cilat i ka adresuar tek organet përgjegjëse dhe ka diskutuar për çështje të ndryshme. Po ashtu ka pranuar për takim qytetarët e Komunës së Drenasit, ndërsa ka ndihmuar Kryetarin në punët e përditshme.

Zyra për Informim - Zyra e Informimit gjatë periudhës raportuese, ka përcjellur aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, web faqës së Komunës, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e prokurimit (njoftimin për kontratë, njoftimin për dhënien e kontratës, njoftimin për nënshkrimin e kontratës dhe njoftimin për anulim të tenderimit) dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellur njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ka përcjellë ftesa, reagime etj. Ka përcjellur agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, zëdhënësi i Komunës, është i ngarkuar me pozitë shtesë për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave fillestare për qasje në dokumente publike dhe në kuadër të saj ka pranuar 16 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe në afatin ligjor i janë përgjigjur 15 kërkesave, 1 ka qenë e pjesshme dhe 1 e refuzuar. Ju kemi përgjigjur 3 formularëve të gjuhësisë nëpër Komuna.

Zyra e Auditorit të Brendshëm - Njësia e Auditimit të Brendshëm ka të miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2016 -2018. Po ashtu kjo Njësi ka të miratuar edhe Planin e Punës për vitin 2016. Me plan të punës për vitin 2016, janë të parapara të kryhen gjithësejt 8 auditime, të cilat do të përfshinë fushat me rrezik më të lartë. Deri me 30.06.2016 janë finalizuar gjithësejt 4 Raporte të auditimit.

Objektivat kryesore të këtyre auditimeve kanë qenë;

- Arritja e pajtueshmërisë me kornizën ligjore në fuqi
- Rritja e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomizimit gjatë shpenzimit të buxhetit komunal
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e komunës,
- Rritja e vlerës së burimeve material dhe humane,
- Rritja e sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara në pasqyrat financiare të komunës, etj.

Të gjitha raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, dhe janë nxjerrur konkluzat për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit. Gjatë vitit 2016, Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka mbajtur dy mbledhje të rregullta dhe ka shqyrtuar dhe miratuar Raportet e auditimit të finalizuara në këtë vit. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrur një qasje gjithpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës. Gjatë këtij aktiviteti ka zhvilluar intervista me menaxherët dhe ka shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrur në këtë drejtim. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore të vitit 2016 ka finalizuar katër raporte dhe ka dhënë gjithësejt 30 rekomandime.

Gjendja e rekomandimeve të dhëna është:

- Gjithësejt janë dhënë 30 rekomandime, (18 në tremujorin e fundit)
- Të implementuara 8 rekomandime,(4 në tremujorin e fundit)
- Pjesërisht të implementuara 6 rekomandime,(3 në tremujorin e fundit)
- Të pa implementuara 16 rekomandime, (11 në tremujorin e fundit) dhe
- 9 rekomandime nuk kanë ende periudhë krahasuese për të vërtetuar implementimin e tyre (9 nga tremujori i fundit).

Ne inkurajojmë menaxhmentin që edhe më tutje të shtoi aktivitetet e tyre për jetësimin e rekomandimeve që janë në proces të implementimit apo ato të pa ardesuara. Gjithashtu falenderojmë menaxherët të cilët kanë arritur që të implementojnë rekomandimet tona të dhëna deri më tani.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME - Nga fillimi i janarit të vitit 2016 administrata komunale është bartur me shërbime në objektin e ri të saj, një investim i Komisionit Evropian, ku orfohen kushte shumë optimale për punë, si për zyrtarët e saj, ashtu edhe për shërbimet ndaj qytetarëve. Plani i punës i DAP është dorëzuar me kohë dhe gjatë këtij gjysëmvetori është duke u realizuar sipas planifikimit. Sektorët më të ngarkuar rezultojnë të jenë Gjendja Civile, Prokurimi dhe QShQK. Sfida: Këtë periudhë kohore e ka përshkuar interesimi i punëtorëve –shërbyes civilë lidhur me Katalogun dhe klasifikimin e vendeve të punës sipas titujve dhe gradave që ai parasheh.

ZYRA E PROKURIMI PUBLIK :

- a. Gjatë periudhës 01.01.2016 deri më 30.06.2016 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë 1733 kërkesa nga të cilat:
 1. Administrata komunale 716
 2. Institucionet arsimore 887 dhe
 3. Institucionet shëndetësore 130
 4. Rexhistrim të faturave 771
 5. Nxjerrja e urdhërblërjeve 770
- b. Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar 58 procedura, prej tyre për:
 1. Vlera minimale 15
 2. Kuotime të çmimeve 11
 3. Punë shtesë 3 dhe
 4. Procedura të hapura 29
 5. Anulime dhe Ri-tenderime të njoftimeve për kontratë 9.
- c. Janë nënshkruar 58 kontrata, prej tyre për:
 1. Vlera minimale 15
 2. Vlera të vogëla 11
 3. Punë shtesë 3 dhe
 4. Vlera të mesme ose të mëdha 29
- d. Janë kryer njoftimet për kontratë, dhënie , anulime dhe pas nënshkrimit të kontratës
 1. Njoftimet për kontratë – 58
 2. Njoftime për dhënie -- 40
 3. Njoftime per anulime -- 9
 4. Njoftime pas nënshkrimit të kontratës – 58

NJKDNJ:

- Meshkujt më tepër dominojnë në pozitat vendimmarrëse, ku nga dhjetë drejtori kemi vetëm një femër drejtore në pozitë udhëheqëse, në bazë të statistikave si vijon:
- Poste vendimmarrëse politike në Komunë janë:13, gjithsej 12 m, 1 f drejtoresh.
- Drejtor/e shkolle, çerdheje 3 f, 29 m, zëvendës drejtor/e 1 f dhe 3 m.
- Drejtore në QKMF 1 f, QPS 1 m.
- Nga shërbyesit civilë janë 28 shefa në administratë, prej tyre 10 f + 18 m = 31
- Gjithsej të punësuar staf civil janë 1300, prej tyre 393 f, 920 m, së bashku me poste vendimmarrëse janë 1313 veta me 393 f dhe 920 m

Sektori	Femra	Meshkuj	Nr. i tërësishëm
Administrata	40	97	137
Arsimi	255	709	964
Shëndetësia	97	102	199
Gjithsej	392	908	1300



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo
 MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSISE - MINISTARSTVO UNUTRANJNJI POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

Dokumentet e lëshuar nga Sistemi i Gjendjes Civile

Komuna Gllago
 Prej 01/01/2016
 Deri 30/08/2016

Lloji i dokumentit	Totali
Ekstrakti i lindjes	18009
Certifikata e lindjes	2802
Certifikata e martesës	2952
Certifikata e vdekjes	843
Certifikata e vendbanimit	522
Certifikata e bashkësisë familjare	3556
Certifikata e gjendjes martesore	770
Certifikata e shtetësisë	203
Vërtetim nga arkiva	434

30091

Numri i qytetarëve që kanë kaluar regjistrin qendror	4454
--	------



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNIJ POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

STATISTIKAT E REGJITRIMIT NË SISTEMIN E GJENDJES CIVILE

KOMUNA: Gllogoc
INSTITUCIONI: Të gjitha
PREJ: 01/01/2016
DERI: 30/06/2016

	Totali
LINDJE	173
1.E rregulltë	87
Brenda vendit	58
Jashta vendit	29
2.Me vonesë	86
Brenda vendit	34
Jashta vendit	52
VERIFIKIME	4103
1.Me numër personal paraprak	3578
2.Me gjenerim të numrit personal	525
RISHKRIM LINDJE	153
REGJISTRIM I QYTETARIT	19
1.Me vendim të komisionit për shtetësi	1
2.Me nenin 28	18
3.Me dekret të presidentit	0
MARTESA	291
1.E rregulltë	263
2.Jashtë vendit	28
RISHKRIM MARTESE	1054
1.Brenda vendit	1040
2.Jashtë vendit	14
SHIKURORËZIME	123
ANULIM TEKENIK	0
NË MES TË DY QYTETARËVE TË HUAJ	0
ME ELEMENT TË HUAJ	62
1.Bashkëshorti huaj	6
2.Bashkëshortja e huaj	56
VDEKJE	148
1.E rregulltë	71

Shqetësuese del një dukuri e theksuar e kërkesave në rritje për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim e qytetarëve tanë me punë nëpër shtete evropiane: Kjo periudhë ka shënuar 47 kërkesa të tilla. Ndërkaq, është simbolik numri i kërkesave për fitimin e shtetësisë së Kosovës, kjo periudhë karakterizohet vetëm me 2 kërkesa për fitim të shtetësisë kosovare. Mirëpo, këto shifra rriten dukshëm në sezonin e pushimeve verore të bashkatdhetarëve tanë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA GLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raport sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

Raport i datës 01/01/2016 deri 30/06/2016

Nr.	Departamenti	Në pritje për pranim	Të pashqyrtuara	Në proces	Miratuara	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezuluar	Totali
1	01-Presidenca	0	33	37	571	122	0	1	764
2	02-Drejtorja për Administratë dhe Personel	0	2	1	24275	6	127	1	24412
3	03-Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet	0	0	5	4310	0	14	0	4329
4	04-Drejtorja për Buqësi dhe Zhvillim Rural	0	0	139	131	0	0	0	270
5	06-Drejtorja për Shëndetësi dhe Mëkëqerje Sociale	0	6	119	562	0	2	0	689
6	07-Drejtorja për Gjeodezi, Pronë dhe Kadashtë	0	26	5	3245	67	12	0	3355
7	08-Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Zhvillim	0	7	69	324	2	0	1	403
8	09-Drejtorja për Arsime dhe Shkencë	0	872	26	12	0	4	0	914
9	10-Drejtorja për Kulturë, Rinë dhe Sport	0	10	23	118	9	0	2	162
10	11-Drejtorja për Punë të Inspeksionit	0	38	165	373	4	3	0	583
11	12-Zyra e Kuvendit Komunal	0	9	27	107	4	0	0	147
12	13-Drejtorja për Shërbime Publike dhe Siguri	0	0	50	249	3	0	1	303
13	14-Zyra Komonale për Komunitete dhe Kërkim	0	0	245	10	0	10	0	265
Gjithsej:		0	1003	911	34287	217	172	6	36596

18 faqes 1

Data e printimit: 01/07/2016



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA GLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Drejtorja për Administratë dhe Personel
Sektori i Oficaris

Data / Datum / Date	01/07/2016				
Nr. / Dr. / No.	Zyrtarisht				
Drejtori / Administrator / Direktor	Z. Xhemë Binaku				
Shefi i sektorit / Nacelnik sektora / Chief of sector	z. Xhemë Binaku				
Për zyrtarin / Za službenika / For official	Për të gjithë zyrtarët				
Lënda / Predmet / Subject	Raport sipas datave, prej: 01/01/2016 deri: 30/06/2016				
Lokacioni / Lokacija / Location	Të gjitha lokacionet				
Envertimet	Numri i kërkesave	Me pagesë	Të liruar nga pagesë	Të anuluar	Shuma totale (Shuma në €)
Të vërtetuarit e dokumenteve	2	2	0	0	8 €
Aktivitetet për regjistrim lindjeje	44	26	18	0	130 €
Aktivitetet për përmirësim emri ose mbiemri	132	99	33	0	495 €
Takë për automjete	1	1	0	0	10 €
Aktivitetet lidhur me regjistrim vdekjes	25	13	12	0	65 €
Shtetësia	18	16	0	0	39 €
Certifikatë lindjeje	2467	1963	499	5	1963 €
Certifikatë martesore	2628	1651	887	8	1651 €
Certifikatë e vdekjes	707	335	362	7	335 €
Certifikatë e vendbanimit	444	319	123	2	638 €
Certifikatë e shtetësisë	264	164	89	1	328 €
Vërtetim nga Arkiva	356	223	127	6	446 €
Certifikatë e qendrës martesore	1073	830	231	12	4150 €
Ekstrakt lindjeje	16403	10604	5707	79	10604 €
Deklarata e bastkësisë familjare	3307	2026	1283	24	4052 €
Gjithsej:	27791	18274	9321	144	24914 €

01/07/2016 03:17

Data e printimit

Xhemë Binaku

Nënshkrimi

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT- Zyrtarët nga Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në planprogramin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit për realizimin e punëve të planifikuara mbartin mbi vete shumë aktivitete në sektorin e planifikimit hapësinor dhe sektorin e projekteve, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, planeve urbanistike, lejet ndërtimore dhe investimet kapitale. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë paraqesim raportin e punës për gjashtëmuorin e parë të punës për vitin 2016 sipas sektoreve :

SEKTORI I PLANIFIKIMIT- Në sektorin e planifikimit jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm të qytetit. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban janë trajtuar brenda afatit ligjor kërkesat, dhe janë dhënë kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane. Poashtu ka filluar të aplikohet edhe ligji për Trajtimin e objekteve pa leje (për legalizime), kemi bërë përgatitjet për procedurat së bashku me zyrtarët në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe deri tani objektet të cilat kanë plotësuar kriteret në bazë të ligjit janë trajtuar me këtë ligj dhe pjesa tjetër janë në procedurë të plotësimit të dokumentacioneve, ose duke pritur ndryshimin e këtij ligji. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit, si dhe legalizimin e objekteve, janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese, të cilat janë kontrolluar nga zyrtarët përgjegjës dhe është bërë kontrollimi i tyre paraprakisht. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë ju kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marrura në harmoni me ligjet ekzistuese.

Tabela e ecurive të lëndëve

Nr	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Pranuara	Aprovuara	Refuzuara	Në Proces
1	Kushte ndërtimi	11	11	x	x
2	Leje ndërtimi	11	11	x	x
3	Leje rrenimi	3	3	x	x
4	Qertifikatë përdorimi	4	2	x	2
5	Leje per lokacion (per trafo, lojra, terasa)	8	4	x	4
6	Pëlqime (Infrastrukturë, bashkim tëparcelave,Urbanistike,projekte ideore)	16	15	1	x
7	Lëshimi i lejeve së përkohshme për aktivitet një ditor	4	4	x	x
8	Kërkesa tjera për financimin e projekteve për nevojat e qytetarëve në infrastrukturë	401	328	x	73
Totali:		458	378	1	79

Gjithashtu janë trajtuar kërkesat për banesa, kontrata tëndryshme, shitblerje etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në databazën elektronike, të krijuar në kuadër të drejtorisë). Hartimi i propozim vendimit për ndryshimin e taksës për leje ndërtimi dhe taksës së densitetit të infrastrukturës, hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e raporteve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Drenasit. Në gjashtëmuorin e parë të këtij viti kanë filluar përgatitjet për realizimin e projektit për vendosjen e shtyllave dhe tabelave për emërtimin e rrugëve dhe vendbanimeve në tërë teritorin e Komunës së

Drenasit, si dhe projekti tjetër që lidhet me përmirësimin e furnizimit me ujë të pijes për 10 fshatra që lidhen nga fabrika për prodhimin e ujit dhe rezervuari në Kamenicë. Për përfundimin e punëve dhe projekteve që realizohen në kuadër të drejtoratit tonë është e nevojshme që të bëhen edhe disa aktivitete në mënyrë që të kemi rezultate sa më të mira.

AKTIVITETET

- Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministrinë e Infrastrukturës, MMPH, Mapletj;
- Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;
- Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtoratit për PUMM.
- Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;
- Hartimet e planeve të menaxhimit të kontratave, raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikëqyrësit e projekteve kapitale;
- Përgatitja e detyrave projektuese për hartimin e projekteve zbatuese për projekte kapitale
- Takime me përfaqësuesit e Agjencitë Kadastrale të Kosovës dhe punëkryesit për projektin e emërtimit të rrugëve dhe numërtimit të objekteve projektifinancuar nga ana e Komisionit Evropian në Kosovë.
- Takimi në Durrës i ekspertëve për hartimin e formularëve të rinj për performancë komunale
- Takimi me përfaqësuesit e Ujësjetës Rajonal, CDI zviceriane në Prishtinë dhe punëkryesit për fillimin e punëve në rrejtin e ujësjetës për 10 fshatra të Komunës sonë.
- Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të drejtorisë sonë dhe drejtorive tjera të Komunës.
- Kontrollimi i projekteve ideore dhe zbatuese të hartuara nga zyrtarët projektues për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte individuale, kolektive dhe projekte kapitale që financohen nga buxheti i Komunës, grantet qeveritare dhe donatorët e ndryshëm.

SEKTORI I PROJEKTEVE - Gjatë realizimit të projekteve kapitale që janë paraparë për realizim në gjashtëmuorin e parë të vitit 2016, nga buxheti komunal, grantet dhe donacionet e ndryshme, ne si drejtori jemi angazhuar me tërë stafin, që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Projektet kapitale si: rrugët, trotuarët, ujësjetës, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike dhe renovime që janë realizuar gjatë këtij gjashtëmuori, janë kryer sipas kontratave dhe pjesa tjetër e projekteve është në procedurë të prokurimit publik. Në të njëjtën kohë, kemi qenë të fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësisht e kënaqshme. Jemi angazhuar si drejtori që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve që i kemi në dispozicion.

PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2016 DHE ATO QË JANË NË PËRFUNDIM

Projekte tjera të cilat janë duke u realizuar :

- Projekte tjera kapitale të komunës (Hartimi i projekteve zbatuese për shkollat për ngrohje qendrore dhe rrethoja në: Terstenik, Krajkovë, Gllanasellë, Korroticë e Epërme etj).
- Kanë filluar punimet për realizimin e projektit për vendosjen e shtyllave dhe tabelave për emërtimin e rrugëve dhe vendbanimeve në tërë territorin e Komunës së Drenasit, ku janë vendosur 635 shtylla ku do të ngjiten 1164 shenja
- Projekti tjetër që lidhet me përmirësimin e furnizimit me ujë të pijes për 10 fshatra me gjatësi 96 km si dhe rezervuari i ujit të pijes në Kamenicë me kapacitet 1000 m³.

Gjithashtu kemi përgatitur me kohë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2017, kemi pranuar me shkrim kërkesat e administratorëve të fshatrave për investime dhe i kemi paraqitur në Kornizën Afatmesme për planifikimin e buxhetit për vitet 2017-2019 para Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Kumunal. Jemi munduar ti japim prioritet projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh kanalizimesh në krahasim me këtë vitin që lamë pas sepse ishin edhe kërkesat e qytetarëve.

PROJEKTET KAPITALE TË PËRFITUARA NGA DONACIONET ME BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT- Përveq projekteve që janë financuar me buxhetin e Komunës sonë, me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës, kemi aritur që të përfitojmë edhe projekte të cilat i financojmë me ndihmën e granteve të qeverisë dhe nga donatorët e ndryshëm. Me seriozitet dhe profesionalizëm kemi arritur t'i bindim këta donator që këto mjete t'i investojnë në Komunën e Drenasit. Projektet që janë financuar në Komunën tonë me ndihmën e granteve dhe donatorëve janë:

Ministria e Infrastrukturës

-Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri ,Komoran dhe Gradicë në vlerë prej 1,000.000€

-Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërdec 50,000 €

Komisioni Evropian

- Projekti për emërtimin dhe numërimin e rrugëve, vendbanimeve dhe objekteve në teritorin e Komunës së Drenasit (vlera do të shënohen në 6 mujorin e dytë pas përfundimit të projektit)

- CDI dhe Ujësjellësi Rajonal i Prishtinës.

- Projekti për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijës për 10 fshatra të Komunës sonë, si dhe kyqja e dy fshatrave tjera në rrjetin e ujësjellësit me gjatësi 96 km, dhe rezervuari i ujit 1000 m³ (vlera do të shënohen në 6 mujorin e dytë, pas përfundimit të projektit) ky aktivitet është duke u zhvilluar dhe mbikëqyrur nga CDI dhe KUR "Prishtuina".

PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË - Zyrtarët e drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, i kryejnë punët dhe detyrat tjera në bazë të ligjeve në fuqi, përshkrimit të vendeve të punës si dhe planit vjetor të punës. Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve në teren, poashtu edhe punëve në zyrë jemi ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme, kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga ngushtimi i rrugëve, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat private e deri te pengimi i realizimit të projekteve kryesisht në mungesë të mjeteve për financimin në tersi të projekteve, si dhe në disa raste kanë ndikuar edhe procedurat e prokurimit të stërzgjatura. Probleme mjaftë të mëdha kemi edhe me kompaninë e KEDS-it, dhe Ujësjellësit sepse nuk janë të përgjegjshëm dhe palët kanë pengesa në kompletimin e dokumentacionit, por edhe në teren në largimin e shtyllave dhe të gjitha këto vështirësi kanë ndikuar në realizimin e planeve dinamike për përmbushjen e objektivave dhe planeve të parapara nga Drejtoria e Urbanizmit.

PROPOZIMET - Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka në fokusin e saj përmirësimin e kushteve për jetesë për banorët e Komunës sonë . Kjo do të arrihet përmes realizimit të projekteve të cilat lidhen drejtpërdrejtë me infrastrukturën urbane e cila lehtëson lëvizjen e njerëzve dhe një jetë normale si dhe duke pasur një planifikim të qëndrueshëm.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT- Raporti i punës së Departamentit për Arsim (DKA) paraqitur Kryetarit të Komunës përfshinë periudhën prej muajit janar-qershor 2016. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamenti janë realizuar më përkushtim dhe më përgjegjësi. Me prezantimin e këtij raporti Kryetari, Kuvendi dhe gjithë qytetarët do të jenë më të informuar, sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellur me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtore të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbëjnë 10 punëtorë: Drejtori, një zyrtar për personel, dy zyrtarë për Arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një zotues dhe një depoist. Drenasi ka një çerdhe, 29 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, 5 paralele të ndara, dy shkolla të mesme, gjithsejtë 37 institucione shkollore. Ku punojnë gjithsejtë 964 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 13849 nxënës. 54 punëtor administrativ, 796 mësimdhënës, 131 punëtor teknik, çerdhja "Ardhmëria" ka gjithsejtë 136 fëmijë,

shkollat fillore prej (I- IX) ka gjithsejtë 1089 nxënës, Gjimnazi "Gj.K.Skënderbeu" ka gjithsejtë 1489 nxënës Shkolla e Mesme Teknike ka gjithsejtë 1333 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS - Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore në Drenas. Në këto takime kemi kërkuar angazhim edhe më të madh të punëtorëve, sidomos në ngritjen e cilësisë në arsim në vitin shkollor 2015-2016, dhe kemi kërkuar respektimin në përpikëri të ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerrura nga MASHT-i. Kemi realizuar takime me prindër, kemi marruar pjesë në manifestimin në Ditën e shkollës në disa shkolla. Aktivitet që ka përfunduar me sukses është edhe kuizi komunal i organizuar në të gjitha shkollat e nivelit të mesëm të ulet, d.m.th. (6-9), ku është treguar ky sukses: në vendin e parë SHFMU "Azem Bejta", Shtuticë, SHFMU "Migjeni", Balçë, në vendin e dytë SHFMU "Bajram Curri" Nekoc, në vendin e tretë SHFMU "Naim Frashëri" Gllobar. Vizita kemi realizuar edhe në institucionet parashkollore, QEAP "Ardhmëria" në Drenas dhe Bushat. Testi i Arritshmerisë me klasë të nënta është përgatitur më kohë sipas planifikimit të MASHT, në test morën pjesë 1230 nxënës, kaluan testin 66% e nxënësve. Vazhdojnë të jenë në funksion marrëveshje për praktiken profesionale me ndërmarrje të vogla për praktiken profesionale të nxënësve, me Ndërmarrja New Coö Feronikeli, kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të kryer praktiken profesionale nxënësit e SHMP "FEHMI LLADROFCI". Matura rezultatet Gjimnazi "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" 80 % kalueshmëria, SHMP "Fehmi Lladrovci" rezultati i maturës 56,5% kalueshmëria, afati i Qershorit.

DONACIONET-Projekti "Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit dhe mësimi elektronik në Arsim, për Gjimnazin "Gj.K. Skënderbeu", Investim i BE-së. Është përfunduar me sukses ky projekt i cili mundëson mësimin elektronik në Gjimnazin "Gj.K.Skënderbeu" në Drenas, në vlerë 26000 euro. Pajisje e sallës së sportit në SHMP "Fehmi Lladrovci", Drenas më të gjitha pajisjet që i duhen një sallë, donacion i siguruar për mesë MASHT-it.

INVESTIMET KAPITALE - Është projektuar dhe pritet të përfundon në këtë vit ndërtimi i sallës së sportit i SHFMU "Xheladin Gashi-Plaku" Komoran, investim i MASHT-it. Është në përfundim ndërtimi i aneksit të shkollës dhe sallës së sportit në SHFMU "7 MARS" Kizhnarekë, investim i MASHT-it. Kanë filluar procedurat për ndërtimin e fushave të sportit në këto shkolla, "Rilindja" Dritan, "Shotë Galica" Abri e Epërme, Lagja e Muliqeve, "Regjep Gjeli" Likoshan, "Azem Bejta" Shtuticë, "Halil Bajraktari" Drenas, investime të Komunës. Kanë filluar procedurat për ndërtimin e rrethojës së shkollës "Shotë Galica" Terdëç, dhe shkollës "Xhevë Lladrovci", Gllanasellë është në procedurë rregullimi i hyrjes të oborrit të Gjimnazit. Kanë filluar procedurat për rregullimin e nxehtësisë qendrore në SHFMU "Gani Elshani" në Krojkovë në SHFMU "Zenel Hajdini" në Tërstenik dhe në SHFMU "Xhevë Lladrovci" në Gllanasellë investim i Komunës. Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e SHFMU "Hasan Prishtina" investim i MASHT-it. Janë bërë projektet për renovimin e SHFMU "Mehdi e Sylejman Bytyqi" Bytyq, paralelen në lagjen Gjergjaj, dhe paralelen në Fushticë, dhe ndërrimi i dritareve në SHFMU "Fazli Grejçevci" Poklek -Vasilevë, investim i Komunës.

KOMUNIKIMI ME MASHT-in -Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in. Ndërsa në investim kapitale punimet janë duke vazhduar, investimet e MASHT-it, vazhdojnë edhe në këtë vit. Në çdo mbledhje me drejtorë të departamenteve për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i, janë paraqit edhe vështirësitë që i ka DKA-në Drenas për pagesat e pushimeve të lehonave dhe tri pagat jubilarë.

BASHKËPUNIMI ME BE-në- Edhe në këtë vit, kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me BE-në për interesin e përgjithshëm të arsimit në Drenas, (BEP.GIZ-in) USAID, etj. Po vazhdon certifikimi edhe i kandidatëve të tjerë për drejtor të institucioneve arsimore në Programin për Udhëheqje dhe Menaxhim të Shkollës. Janë certifikuar shumica e mësimdhënësve nga projekti i BE-së i implementuar nga GIZ-i, në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimdhënësve po vazhdojnë edhe gjatë këtijë viti shkollor, po ashtu vazhdojnë trajnimet e mësimdhënësve për kurrikulën e re.

VËSHTIRËSITË - Vështirësitë janë edhe obligimet financiare të mësimdhënësve të pa paguar gjatë zëvendësimeve të pushimeve mjekësore, (pushimet e lehonave), tri pagat jubilarë të mësimdhënësve. Staf i profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK- Kjo Drejtori gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lemit përkatëse që janë kompetencë e sajë, në bazë të Statutit të Komunës, ku është obligim dhe përgjegjësi e kësaj Drejtorie, që të zbatojë dispozitat ligjore lidhur me të gjitha lëmitë që janë në kompetencë të sajë. Në komunën e Drenasit Bujqësia po shëndrrohet në një sektor të rëndësishëm të Zhvillimit Ekonomik, dhe duke patur parasysh kushtet e volitshme, si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në atë klimatik, Komuna e Drenasit, ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetin e prodhimeve bujqësore, si në sasi po ashtu edhe në cilësi, ku në mënyrë që të zvoglojm konsumimin e prodhimeve nga importi dhe në tryezat tona të servohën sa ma shumë produkte vendore. Gjithashtu janë bërë reforma të volitshme në politikat administrative dhe fiskale për të gjitha bizneset që operojnë Komunën e Drenasit duke krijuar një ambient të volitshëm për investitor të ndryshëm.

NE 6 MUJORIN E PARË 2016 SEKTOR I BUJQËSISË KA KRYËR KETO PUNË :

- Këshillimet për fermer rreth aplikimit për Grande te ndryshme, ne sektorët e ndryshëm të bujqësisë, si dhe kompletimi i te gjithë dokumentacionit te këtyre fermerëve për të aplikuar ne MBPZHR.
- Këshillimet për fermer rreth aplikimit për subvencione ne pagesa direkte ne sektorët ndryshëm te bujqësisë.
- Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik ka furnizuar me makina mjelëse për lopë qumështore për 71 fermër-blegtor të cilët i posedojnë mbi 5 krerë lopë qumështore. Vlera e këtij projekti ka qenë 164.90 € për një makinë, dhe vlera në total e këtij projekti është 11,707.90 €.
- Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve ne kulturat e ndryshme bujqësore të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare (te reshurat atmosferike-breshri dhe nga temperaturat e ulëta), dhe janë dorëzuar ne MBPZHRE për kompensim te këtyre dëmeve te fermerëve.
- Këshillim te fermërve për te gjitha sektorët e ndryshëm bujqësorë.
- Bashkpunimi me IADK-në ne sektorin e bujqësisë.
- Janë mbajtur trajnime me fermeret e lemive të ndryshme bujqësore.
- Tek fermerët është bërë shpërndarja e disa broshurave bujqësore rreth 415 copë.
- Janë lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë 147 Çertifikata (NIF-it) të Regjistrimit te fermerëve.
- Janë mbajtur trajnime me fermër nga: IADK-ja, KDC-ja, Shoqatat Gratë në Biznisë, USAID-i, CONSULT INGENEERING etj.
- Është bër planifikimi i te mbjellurave vjeshtore 2015-2016 dhe realizimi i tyre (Mbjelljet vjeshtore të planifikuera për kulturat e ndryshme 3670 ha, dhe prej tyre janë realizuar 2420 ha).
- Planifikimi dhe realizimi i kulturave të ndryshme pranverore (Te planifikuara 2941 ha dhe te realizuara 2877 ha).
- Pregaditja rreth Korrije –Shirjeve me MBPZHR, auto Kombanjeret, fermeret dhe pikat grumbulluse të drithërave në teritorin e Komunës së Drenasit.
- Nga kompania – Ndërmarrja e “ IBËR LEPENCË” Njësia e Punës ne KOMORAN, gjatë këtij gjashtëmuajori të parë te vitit 2016 është punuar në rregullimin e rrjetit të ujitjes, dhe ndrrimin e pjesëve të dëmtuara ne rrjete në mënyrë që të zgjerojmë sipërfaqet e ujitura, ku tani rrjeti i ujitjes është i AFTËSUAR ne mbi 2610 ha.
- Ka filluar projekti “Zhvillimi i Zonave Rulale” përmes avancimit të shërbimeve këshillimore është duke indentifikuar temat më të rëndësishme, si problemet ashtu dhe njoftimet të cilat do të jenë të rëndësishme për fermeret. Kjo do t'i ndihmojë që fermerët të jenë të informuar për problemet, afatet e kultivimit si dhe mundësit te ndryshme në shërbime bujqësore.
- Janë mbajtur trajnime me fermer nga: ESG, IADK, KDC dhe USAID. etj.
- Organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve me fermer për sektor përkatës të bujqësisë.

Subvencionet:

- Shpërndarja e njoftimeve për fermerët rreth aplikimit për pagesa direkte për mbjelljen e grurit, misrit, lule diellit, farë gruri, pemëve dhe perimeve. Ku gjithsejtë kanë aplikuar për subvencionet e grurit dhe misrit janë 759 fermer me sipërfaqe te përgjithshme prej 2942.65 ha (me sip. të grurit 2080.86 ha, me sip. te misrit 695.95 ha, me elb 6.99ha, me pemë 95.20 ha dhe me perime 41.72 ha), si dhe udhëzimet për

fermerët rreth aplikimit DIGITALIZIMIT dhe udhëzime rreth aplikime te fermerëve për grande ne MBPZHR për sektorët e ndryshëm bujqësor.

- Pran drejtoratit për DBZHE janë bërë te gjitha pranimet e aplikacioneve te ndryshme për fermerët qe kan aplikuar për programet e ndryshme qe subvencionohen nga MBPZHR dhe janë kompletuar, proceduar dhe dërguar ne Ministrin e Bujqësisë .
- Të mbjellurat me grurë, ku kanë aplikuar 527 fermer, me një sipërfaqe prej 2080.86 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritët ta përfitojnë fermerët tanë është 312,129.00 €
- Të mbjellurat me misër, ku kanë aplikuar 265 fermer, me një sipërfaqe prej 695.95.00 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritët ta përfitojnë fermerët tanë është 104,392.50 €.
- Të mbjellurat me elb, ku kanë aplikuar 5 fermer, me një sipërfaqe prej 6.99 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritët të përfitojnë fermerët tanë është 699.00 €
- Plantacione me pemë, ku kanë aplikuar 87 fermer, me një sipërfaqe prej 95.20 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritët ta përfitojnë fermerët tanë është 38,080.00 €.
- Ne fushë hapur (perimkultur), ku kanë aplikuar 24 fermer, me një sipërfaqe prej 40.72 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritët të përfitojnë fermerët tanë është 12,216.00 €.
- Shpërndarja e njoftimeve për fermerët rreth aplikimit për subvencione te lopëve qumështore, dele, dhive, bletëve dhe për litër te qumështit. Ku gjithsejtë kanë aplikuar për subvencionet e tyre 287 fermer në sektor të ndryshëm të blegtorisë dhe bletarisë, si dhe udhëzimet për fermerët rreth aplikimit dhe udhëzime rreth aplikime te fermerëve për grande ne MBPZHR për sektorët e ndryshëm bujqësor.
- Subvencionimi i lopëve nga MBPZHR me nga 70 € për krerë, ku kanë aplikuar 208 fermer me 1505 krerë lopë qumështore, ku shuma e përgjithshme qe pritët të përfitojnë fermerët është 105,350.00 €.
- Subvencionimi i deleve nga MBPZHR me nga 15 € për krerë, ku kanë aplikuar 43 fermer me 3764 krerë dele ku shuma e përgjithshme qe pritët te përfitojnë fermerët është 56,460.00 €.
- Subvencionimi i dhive nga MBPZHR me nga 15 € për krerë, ku kanë aplikuar 15 fermer me 702 krerë dhi ku shuma e përgjithshme është 10,530.00 €.
- Subvencionimi i shoqërive me bletë nga MBPZHR me nga 10 €, ku kanë aplikuar 58 fermer me 3561 shoqëri bletë ku shuma e përgjithshme qe pritët të përfitojnë fermerët është 35,610.00 €.
- Subvencionimi për pula vojse me nga 0.50 € për copë, ku kanë aplikuar 2 fermer, me numër te pulave vojse prej 15850 copa, ku shuma e përgjithshme qe pritët të përfitojnë fermeri është 7,925.00 €.
- Subvencionimi i thëllëzave ku ka aplikuar 1 fermer me 15000 copa me nga 1.00 € për copë dhe shuma që pritët te përfitoj fermeri është 15,000.00 €.
- Subvencionimi për litër qumështi me nga 0.06 € per ekstra klas, 0.04 € per klasin e parë, 0.02 € për klasin e dytë, ku kanë aplikuar 7 fermer me 115 krerë lopë ku shuma e përgjithshme qe pritët te përfitojnë fermeret varet nga klasa, në bazë të % se yndyrës dhe në bazë të % se qelizavë somatike te qumështit dhe sasia e qumështit qe do ta dorëzojnë fermerët ne pikën grumbulluese, për çdo tre mujorë të vitit.
- Është bërë përgatitja për korrije-shirje.

SEKTORI I EKONOMISË - Sipas Qendrës Komunale **ONE STOP SHOP** për Biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2016 deri me datën 30.06.2016 janë të regjistrua 148 biznese të reja, krahasuar me periudhën paraprake të vitit 2015 që ishin regjistruar 141 biznese ose shprehur në përqindje **5.00%** më shumë se në gjashtëmujorin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 252 punëtorë. Bizneset fillestare brënda ditës paisën me çertifikatën e biznesit, numërin fiskal me deklarim vullnetar paisën edhe me çertifikatën e TVSH dhe çertifikatën doganore. Në këtë qender jepen të gjitha konsulencat e nevojshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa ma të volitshëm për regjistrimin dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	148	100.00%
Të mesme	5 - 60	-	-

Të mëdha	60- e më tepër	-	-
Gjithsejt:		148	100.00%

Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2016– 30.06.2016 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (100.00%)

Nr .	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. Sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregti	39	27.00%
2.	Transporti	18	12.00%
3.	Ndërtimtari	25	15.00%
4.	Hoteleri	10	7.00%
5.	Bujqësia	21	15.00%
6.	Shëndetësi	11	8.00%
7.	Industri- zëjtari prodhuese	14	10.00%
8.	Arsim	9	6.00%
	Gjithësejtë.....	148	100.00 %

Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	135	91.00%
2	Ortakëri e përgjithshme		
3	Ortakëri e kufizuar		
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	13	9.00%
5	Shoqëri Aksionare		
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj		
7	Ndërmarrje publike		
8	Kooperativë bujqësore		
	TOTALI	148	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2016 – 30.06.2016 në Komunën e Drenasit. Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe, ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 91.00%. Gjatë periodës 01.01.2016 – 30.06.2016, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: 63 ndryshime të bizneseve ekzistuese, në periudhën paraprake të vitit 2015 bizneset që patën ndryshime ishte 37 biznese ose 48.00% ma pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2015 dhe sipas muajve dukën kështu:

Nr.		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali					
1.	Ndryshi me në biznese	10	6	5	4	7	5	37					

Janë regjistruar 21 shuarje dhe janë ndërruar 17 certifikata me logo të UNMIK-ut si dhe janë zëvendësuar me certifikata me logo të Republikës së Kosovës . Në periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016 janë Arkivu 321 lëndë, janë faturuar dhe paguar 33,650.00 euro taksë komunale, janë dorëzuar raporte për biznese në MTI, konsulenca rreth bizneseve, sistemimi dhe azhurimi i lëndve në foldera dhe programe të caktuara janë shtyp dhe protokolu 175

Aktvendime për taksën komunale dhe janë dorëzuar për shpërndarje, sidhe janë kry punë të tjera sipas nevojës së DBZHE .

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMËRGJENCË - Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Emergjence bazuar në Statutin e Komunës nenit 82 mbështetur në kompetencave dhe detyrata që i takojnë, duke respektuar ligjislacionin dhe udhëzimet administrative gjatë tremujorit të parë të vitit 2016 ka paranuara një nr. të madh të kërkesave nga qytetarët. Qellimi i ynë ka qenë dhe është zgjidhja e tyre në menyrë sa ma efikase dhe në kohë sa ma të shpejtë. Lidhja e kontratave me kohë dhe syunimi që të kemi me shumë kontrata kornizë në shumë projekte kapitale ka mundësuar shërbim më të shpejtë dhe më cilësor për intervenimet në teren.

Tab. 1 Numri i kërkesave

Nr.	Në pritje për prnim	Të pashqyrtuara	Në process	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Totali
1	0	2	50	247	4	0	303

Tab. 2 Projektet të cilat janë duke u realizuar për vitin 2016

Viti 2016	Kontratat e lidhura për vitin 2016	
1	Mirëmbajtja e parqeve dhe gjëlberimi i qytetit	Kontratë e lidhur
2	Renovimi i rrugëve të asfaltuara	Kontratë e lidhur
3	Mirëmbajtja e kanaliz. Fekal, atmosf. dhe gr. septike	Kontratë e lidhur
4	Pastrimi i deponive të egra	Kontratë e lidhur
5	Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal	Kontratë e lidhur
6	Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina	Kontratë e lidhur
7	Mirëmbajtja e rreugve gjatë verës	Kontratë e lidhur
8	Mirëmbajtja e rreugve të renditë katërt me zhavor	Kontratë e lidhur
9	Trajtimi i Qenëve endacak	Kontratë e lidhur
10	Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore	Kontratë e lidhur
11	Renovimi Ndriqimit Publik me sistemin inteligjent dhe me llaba LED	Kontratë e lidhur
12	Rregullimi i varrezave në komunën e Drenasit	E shpallur
13	Ndertimi i bustit të heroit FEHMI LLADROVCI	Në proces
14	Vendosja e kamerave në qytetin e Drenasit	Në proces

Nga shërbimi i zjarrfikësve realizimi i numrit të përgjithshëm i daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve gjatë kësaj periudhe kohore.

Tab. 3 Intervenimet

VITI 2016	INTERVENIMET							
Nr.	Nr. i përgj. të daljeb	Nr. i zjarreve	Të rejshe	Intervenimetekni ke- Aksidentale	Vërshime	Shërbime	Të Lënduar	Të Vdekur
Janar	17	6	/	1	10	2	/	/
Shkur	8	7	/	/	1	/	/	/
Mars	15	3	/	3	7	2	/	/
Prill	19	19	/	/	/	/	/	/
Maj	15	7	/	2	2	5	/	/
Qershor	13	9	/	1	1	2	/	/
Gjithësej	87	51	/	7	21	11	/	/

Sfidata: Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Emergjence ka marrë në menaxhim Stacionin e autobusëve nga data : 01.02.2016 për qka është dashur angazhime shtesë. Numri i vogël i stafit karrshi numrit të madh të projekteve dhe i sektorve që mbulon DSHPE është një sfidë tjetër në këtë drejtorat.

DREJTORIA PËR BUXHET E FINANCA- Drejtori për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës Janar-Qershor/2016, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Planprogramin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orjentuar në këto lëmi:

- plani i punës për vitin 2016,
- raporti i punës dhe financiar për vitin 2015,
- pasqyrat financiare 2015,
- procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2017-2019, sipas kërkesave të programeve,
- raportet financiare sipas muajve dhe periudhave të gjashtë mujorit të parë /016,
- aprovimi i shpenzimeve dhe çertifikimi për buxhetin komunal sipas programeve ,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),
- punët lidhur me arkën e parave të gatëshme (arkëtimi dhe pagesat),
- regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK-në,
- autorizimi i shpenzimeve për Drejtoratin për Buxhet dhe Financa,
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit-MF-së,
- caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2016,
- caktimi i taksave dhe ngarkesave tjera,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve ,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- punët lidhur me zbatimin U.A nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Komunale
- punët lidhur me përgatitjen e propozim vendimeve dhe vendimeve për buxhetin,
- përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB-i) 2017-2019 ,
- shlyrja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për buxhetin 2017-2019, sipas programeve,
- punët lidhur me ridentimin-transferin e mjeteve buxhetore të vitit 2016,
- në trajnimin e puntorëve të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.
-
- 1. **Sektori i Buxhetit** - Për periudhën raportuese, ka kryer këto punë dhe detyra pune:
 - zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2017-2019, sipas kërkesave të programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve,
 - përgatitja e Qarkores 01/016 Interne buxhetore,
 - përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-i) 2017-2019,
 - vërtetimi i deklaratave të nevojës për sigurimin e parasë publike lidhur me projektet kapitale dhe projektet tjera, para shpalljes së tenderve,
 - aktivitetet lidhur me informimin e qytetarve për të marrur pjesë në planifikimin e buxhetit komunal për vitet në vijim 2017-2019,

- përgatitja e formularve për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve lidhur me buxhetin komunal 2017-2019, sipas programeve,
 - punët lidhur me ridestinimet-transferet e mjeteve sipas nevojës ,
 - përgatitja e planit të zotimit dhe shpenzimit të parasë publike sipas programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve për vitin fiskal 2016,
 - aktivitetet e zhvilluara për organizimin e dëgjimeve buxhetor me qytetarët e Komunës së Drenasit ,
 - përgatitja dhe dërgimi i raporteve në MF-Departamentin e Thesarit lidhur me faturat e pa paguara sipas muajve,
 - caktimi i taksës për personat që kanë pasuri të luajtshme, në numër prej 6112,
 - numëri i kontratave për transferin e pronës të vertetuara 66 ,
 - për personat që janë pronar- shfrytëzues të pasurisë së palujtëshme (objekte), janë lëshuar 3235 vërtetime,
 - për personat që janë pronar të pasurisë së luajtshme janë lëshuar 6112 vërtetime,
 - numëri i vërtetimeve tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit gjithësejt janë lëshuar 1329 çertifikata,
 - numëri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal 1221, si dhe zotimi i mjeteve sipas kërkesave,
 - regjistrimi i pagesave të tatimpaguesve përmes arkës 24,
 - lëshuarja e faturave sipas kërkesës së palëve 2314,
 - ruajtja e databazës për të dhënat e regjistruara,
 - objektet e reja të matura – rimatura 186,
 - fatura të shpërndara përmes poste 10374 ,
 - numëri i ankesave të pranuar 44 ,
 - pranimi i kërkesave për verifikimin e objekteve të pa luajtshme 229,
 - regjistrimi i kontratave të shitblerjeve 31,
 - korigjimi manual i pagesave 384,
 - riprogramimi i marveshjeve për pagesë në sistem 112,
 - korigjimi manual i faturave të përllogaritura gabim 384,
 - modifikimi i të dhënave për cilsinë e objektit në bazë të fotografisë 229,
- Angazhimet e bëra nga Zyra e Tatimit në Pronë-DBF, lidhur me arritjen e një performance të ngritur për arkëtimin e tatimit në pronë, pasqyrohet nëse bëjmi krahasimin e planifikimit (175.000,00€) si të hyra vetanake me arkëtimin (171.889.00€) i cili paraqet arritjen e objektivit për 98.22%.

2. Sektori i Thesarit- Në këtë sektor punët dhe detyrat e punës, janë kryer si vijon:

- numëri i shërbimeve lidhur me arkëtimin e parave të imta për shërbime në Administratë ka qenë 8985, Gjeodezi 2805, Urbanizëm 151,Financa 3258, Shendetësi 283, Arsimit 200, Bujqësi 153,Shërbime Publike 12, Z.Kryetarit 53, gjithsej:15900 shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveq arkëtimit , është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
- regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në database dhe në sistemin e Free-balancit,
- transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari e vetme të thesarit MF për çdo fund muaji ,
- barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe Ministris së Financave,
- punët lidhur me pasurinë komunale të dhën në shfrytëzim,
- zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, numëri i lëndve 400 dhe sipas modulit të aprovimit, në numër prej: 357,
- kryerja e pagesave nga buxheti i komunës (dhjetë drejtorate dhe tri zyre komunale) për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara, në numër prej: 1221. Vlen të cekët se 100% e lëndve të pranuar në zyrën e pagesave janë proqesuar për pagesë. Nëse bëjmë një krahasim të këti shërbimi me periudhën e njëjtë të një viti më parë, vërehet se kemi patur zvoglim të lëndve për -15% ,
- kryerja e barazimeve mujore-perjodike me Departamentin e Thesarit ,

- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektoreve kryesor dhe programeve,
- bazuar në Rregulloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore është bërë regjistrimi i pasurive jo financiare kapitale të evidentuara në vlerë prej:1,554,650.00€. Në këtë vlerë janë përfshirë tokat, ndertesat, pajisjet, infrastruktura, si dhe automjetet, pasuri komunale. Pra në SIMFK janë të përfshira të gjitha këto kategori. Duke siguruar dokumentacionin siq edhe kerkohet me Rregullore për të regjistruar një pasuri.
- 3. **Sektori i Financave.**- Në periudhën janar-qershor/016, përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:
 - çertifikimi-aprovimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyreve komunale me modulën e blerjes, në numër prej 890 lëndë,
 - çertifikimi-aprovimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit, në numër prej 331 lëndë,
 - përgatitja e regjistrimit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar,
 - është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e çertifikuara-aprovuara sipas shpenzimeve veq e veq,
 - raporti i punës-financiar për vitin /2015,
 - pasqyrëzat financiare për vitin /2015,
 - raporti i kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale për Ministrin e Financave dhe Kryetarin e Komunës,
 - raportet mujore financiare,
 - raportet periodike financiare/016,
 - plani i punës për vitin 2016
 - regjistrimi i të gjitha lëndëve të aprovuara në librin e dorëzimit për arhivë dhe dorëzimi i tyre për arhivim sipas dispozitave ligjore.

Me kërkesën e Departamentit të Thesarit –MF, punëtorët e këtij Drejtorati që përdorin Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar, janë ri trajnuar dhe Çertifikuar për përdorimin e moduleve përkatëse në Sistemin.

Për periudhën raportuese, DBF ka planifikuar të arkëtoi mjete në shumë prej:245.000.00€; ndërsa me gjendjen e të dhënave 30.06/016, janë arkëtuar mjete në shumë prej:224,935.00€, apo shprehur në përqindje 91.81%. Nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa, gjatë periudhës raportuese, janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar në punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës, si dhe Ministrinë për Financa.

4. **Masat e propozuara.**- Për të qenë sa më efikas në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës, që janë të parapara me Statutin Komunal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, rregulloret dhe vendimet në fuqi dhe programin e punës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa (D.B.F) propozon këto masa:
 - vendosjen e adresave dhe numërave në objektet e pa luajtshme në tërëtorin e Komunës së Drenasit,
 - informimin e obliguesve të tatimit në pronë që t'i paraqesin ndryshimet eventuale në pronën e tyre siq janë: Ndërtimi i shtëpive dhe objekteve tjera të reja, ndërrimi i destinimit të objekteve për mënyrën e shfrytëzimit, si dhe informimi për objektet e rrënuara,
 - rritja e stafit në Zyrën e Tatimit në Pronë,
 - vazhdimi i aplikimit të masave për moskryerjen e disa shërbimeve komunale ndaj obliguesve tatimor,
 - krijimi i mundësive për stimulimin e punëtorëve në punë.

DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË -

Kjo Drejtori kryen një veprimtari specifike, profesionale të punëve dhe detyrave të punës me interes të përgjithshëm të qytetarëve, personave civil –juridik. Mban evidencën e të gjitha Tokave të Komunës së Drenasit të ndarë në 35 zona kadastrale, lidhjen e Hipotekave dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme kadastrale etazh, kadastrale nëntokësor etj.

Bashkëpunimi i drejtorisë me organe dhe subjekte të tjera të Komunës. Në kuadër kompetencës së vet teknike profesionale dhe administrative, punën e vetë e kryen në bashkëpunim të ngushtë dhe të përhershëm me kryetarin e komunës , Kuvendin dhe Agjencia e Kadastrale të Kosovës. Me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit për të gjitha projektet punët gjeodezike janë kryer nga punëtorët e kësaj Drejtorie , sidomos me rastin e ndërtimit të rrugëve Lokale në përkufizimin e tyre dhe heqjen e pengesave të pronësore.

Sektori i Gjeodezisë - Nga punët e sektorit, është bërë organizimi i tyre, ndarja e detyrave individuale dhe grupe, kontrollimi dhe aprovimi i punëve në aspektin profesional, ligjor dhe financiar. Punimi i informative gjeodezike dhe financiare mujore dhe koordinimi i rregullt dhe ditor me eprorin e organit.

Kërkesat e terenit dhe llojet e tyre në periudhën raportuese:

- Për matje.....	50 kërkesa
- Rivendosje e kufirit	11
- Nderrim kultures	5
- Bashkim parcele	7
-Azurim- koordinata	8
- Regjistrim banese – lokali	12
-Kërkesa për informacione,përgjigje të ndryshme etj.....	14
Gjithësejtë :	107

Nga këto lloje të kërkesave që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me interesat e qytetarëve janë shqyrtuar të gjitha. Në procedurë janë 14 kërkesa ,për arsye të ndryshme e sidomos në bazë të kërkesave specifike dhe të arsyeshme të palve. Është duke u punuar në sistemin e ri të punëve gjeodezike ,në kadastrin e koordinatave gjegjësisht në "map system". Përkundër vështirësive evidente që paraqiten në saktë të mungesës së planeve të azhurnimit dhe gjendjes së pa azhurnuar , çdo ditë shihen rezultatet pozitive në këtë lëmi. Në bashkëpunim me sektorin e pronës janë vendosë në teren dhe janë përpunuar në aspektin gjeodezik 49 raste. Në disa raste përveç procedurës së rregullt është dashtë me përgatitë informata dhe përgjegje të veçanta. Janë vendosur mbi 49 raste të tatimit në pronë. Puna me palë në këtë sektor është mjaft voluminoze dhe me shumë me përgjegjësi. Në periudhën raportuese kemi pas mbi 28 raste palë për nevoja dhe interesa të ndryshme që kishin të bënin me pronat , çështje kontestuese në disa raste shumë të ndjeshme ,bile edhe konfliktuoze për çështje pronësore etj.

Sektori i Pronës - Gjatë periudhës kohore nga Janari e gjerë me 30 Qershor të vitit 2016, në Sektorin e Pronës në kuadër të Drejtoratit për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë janë kryer përafërsisht të gjitha punët sipas plan-programit të punës për vitin 2016.

-Janë realizuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga administratorët e fshatarave, madje kërkesat nga personat juridik e fizik si dhe kërkesat në bashkëpunim me organet tjera të Komunës e që janë në lidhmeri me sektorin e pronës.

-Shprehur në gjendje numerike në periudhën raportuese janë realizur 19 kërkesa të paraqitura, do të thotë se kemi qenë në teren për 19 raste, kemi zhvilluar procedurë administrative dhe të gjitha keto raste janë perfunduar me sukses. Është zhvilluar edhe procedura për raste ku është uzurpuar prona publike (kryesisht të zënja e rrugëve publike) e që për 4 raste është perfunduar procedura administrative e uzurpimit, janë leshuar 2 aktvendime në shkallë të parë gjithashtu në shkallë të dytë janë verifikuar dhe janë vertetur gjerë tani 2 aktvendime të cilat tani kanë kaluar për ekzekutim në Drejtoratin e Inspeksionit.

-Me angazhimin tonë profesional në teren dhe me ndikimin tonë zyrtar të disa palë kemi arrit që ende pa perfunduar procedura administrative e uzurpimit të pronës komunale-publike , të lirohen 4 ari pronë publike e Komunës pas intervenimit me Inspeksion në lagjen e urbanizuar në Komoran pastaj janë liruar 2.5 ari në fshatin

Nekoc dhe 4 ari në fshatin Qikatovë e vjeter (me ekzekutim në bashkpunim me organin e inspeksionit)

-Janë trajtuar disa raste lidhur me eksproprijimin e pronave, pastaj edhe disa raste për vendosjen e largperquesve nga KEK-u, si dhe disa lëndë kontestuese lidhur me eksproprijimin e meherdhëm të pronave nga gurthyesi në Q. të Vjetër, pastaj është verifikuar gjendja e pronave sipas elaboratit për shpronësimin në rregullim të shtratit të lumit Drenica. Është trajtuar edhe kërkesa për varreza në fshatin Gllabar, ku janë bërë inqizimet në terren dhe është nxjerrë kopja e planit si dhe një Propozim – Vendim për ato varreza.

-Pas trajtimit të rasteve nga kërkesat u janë kthyer 12 përgjigje zyrtare me shkrim atyre palëve për kontestet e paraqitura në terren si dhe për ato të cilat i kanë zonat komasative e që në kemi orjentuar në komisionin për komasacion të komunes i cili është në funksion.

-Janë shqyrtuar disa oferta për shit-blerje të paluajtshmerive nga palët dhe për këto raste nga ky sektor janë lëshuar 8 certifikata që Komuna nuk është e interesuar për blerje të pronave –paluajtshmerive nga personat fizik (ofertuesit).

-Janë lëshuar 8 certifikata që pronat e shitur-blerë nga personat fizik në Komunën e Drenasit nuk kanë qenë të nacionalizuara. Në vazhdimi kemi bashkpunuar me sektorin e Gjeodezisë dhe të kadastrit si dhe me Drejtoratin për Inspeksion dhe organet tjera. Kemi kryer në këtë sektor edhe punë tjera bashkpunimi me organet e tjera të Komunës gjithëherë në të mirë të qytetarëve të Komunës sonë.

Punët administrative - Raporti gjashtëmuor për vitin 2016 për regjistrimin e pronës së paluajtshme nga Zyra e Kadastrit.

- 1.Kontrata mbi shitblerjen e pronës së paluajtshme - 42 raste,
- 2.Aktvendime të Trashëgimisë - 21 raste,
- 3.Kontrata mbi dhurimin - 32 raste,
- 4.Aktvendime për Hipotekë - 35 raste,
- 5.Aktvendime mbi fshirjen e Hipotekës - 7 raste,
- 6.Aktvendime mbi ndarjen e parcelave - 34 raste,
- 7.Kontrata të Qirambajtjes-nënqirambajtje për 99 vite - 9 raste,
- 8.Kontrata mbi regjistrim banesave-lokale - 20 raste,
- 9.Kontrata mbi ndarjen e bashkësisë familjare - 3 raste.
- 10.Korigjime të emrit dhe mbiemrit - 10 raste
- 11.Bashkim parcelash - 7 raste
- 12.Regjistrim i trolit - 3 raste dhe 15 - raste tjera.

GJITHËSEJT----- 238 raste

DREJTORIA E INSPEKTORIATIT - Drejtoria e Inspeksionit duke u bazuar në planin operativ për vitin 2016 si dhe në përputhje me Ligjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Rregulloret e Komunes së Drenasit, punët dhe detyrat e punës i ka kryer sipas fushëveprimtarive të inspektorëve. Kjo Drejtori në të gjithë lëmitë inspektuese është mjaft aktive, me gjithë problemet e mëdha që rëndojnë këtë trevë e të përsëritura vite me

radhë. Punët dhe detyrat e punës gjatë kësaj periudhe janë kryer sipas detyres zyrtare, kërkesave dhe realitetit si dhe mundësive ekzistuese në terren.

Më poshtë do të japim një pasqyrë të punës së realizuar për periudhën janar-qershor 2016:

- Mbikëqyrja e ndertimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndertimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.
- Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, paisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj.
- Mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazhuara dhe të paambalazhuara, ujit të pijshëm dhe kualitetit të tij,
- Mbikëqyrja e pastertisë së qytetit, tregjeve, rrugëve, trotuareve e sidomos inspektimi rreth ujrave të zeza në zonat rurale.
- Mbikëqyrja e kompanive private dhe publike të transportit, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.
- Inspektimi i subjekteve afariste për kryerjen e obligimeve-taksave komunale
- Mbarëvajtja e tregjeve javore në Drenas dhe Bushat.
- Inspektimi rreth largimit të bores para lokaleve dhe në trotuare gjatë sezonës së dimrit.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave të palëve dhe nenojave në teren.

Gjatë punës së saj kjo Drejtori vazhdimisht ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, gjegjësisht Stacionin Policor në Drenas. Në të gjitha lemitë inspektuese është punuar nga secili inspektor në kuader të kompetencave ligjore, rrethanave në teren dhe në përputhje me realitetin ekzistues në teritorin e Komunes së Drenasit. Vazhdimisht është bërë koordinimi i punëve dhe detyrave të punës në teren dhe është bërë përcjellja e punës së inspektorëve, në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe janë dhenë sqarime profesionale. Në vazhdimësi është përcjellë bugjeti për periudhën janar-qershor 2016, zotimet dhe shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale. **Nga lëmia e Inspektorit sanitar** - është bërë mbikëqyrja e higjieniko-sanitare të lokaleve afariste hoteleve, kuzhinave popullore, qebaptoreve, restoraneve, embëltove, lokaleve të ondulimit, shkollave etj. Një kujdes i veçantë është kushtuar respektimit të ligjit për pirjen e duhanit, mallrave me afat të skaduar dhe konfiskimi i tyre, ujit të pijes etj. Për të gjitha këto janë hartuar procesverbale, aktvendime dhe janë marrë masa të nevojshme. Për këtë janë hartuar procesverbale, aktvendime, pelqime sanitare, si dhe është konfiskuar mall me afat të skaduar në vlerë prej 238,20 euro. **Nga lëmia e tregut** - dhe qmimeve për periudhën janar-qershor 2016 është bërë inspektimi rreth qertifikatave të biznesit, qmimeve, orarit të punës, deklaracionit të mallit, mbrojtjes së konsumatorit etj. Sidomos kujdes i veçantë në bashkëpunim me ATK-në i është kushtuar bizneseve të lojrave të fatit se a i plotësojnë kushtet për këtë lloj veprimtarie. Sa i perket zbatimit të orarit të punës në bashkëpunim me PK-në është inspektuar edhe gjatë orëve të nates. **Sa i perket lemisë së komunikacionit** problem në vete gjatë kësaj periudhe kanë qenë kombibuset me 8+1 ulëse të cilëve me Ligjin më të ri mbi komunikacionin nuk iu lejohet ushtrimi i veprimtarisë. Megjithatë Inspeksioni në bashkëpunim me PK-në ka arritur që në masë të dukshme të ndalojë operimin e kombibuseve. Kështuqë vazhdimisht ka pasur konfiskime të kombitaksive si dhe janë zhvilluar procedura kundërvajtëse dhe në masë të madhe këta operatorë janë larguar nga qarkullimi, si dhe është duke u punuar në kontiunitet me PK. Për këtë pos që janë hartuar procesverbale, janë konfiskuar automjete, targa të regjistrimit si dhe janë dërguar lëndë në Gjykatë. **Nga lëmia e Inspektorit financiar** edhe pse punëtori një kohë ka qenë për shërim jashtë vendit, punët dhe detyrat i ka kryer me autorizim punëtori i lemisë tjetër përkatëse me autorizim, në mënyrë të dukshme është arritur në inkasimin e taksave komunale sipas Rregullores për taksa dhe gjoba. **Inspektori i ambientit** gjatë kësaj periudhe ka qenë i angazhuar rreth mirëmbajtjes së pastertisë së qytetit, mbrojtja e ambientit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujrave të zeza, sidomos në zonat rurale, sipas kërkesave të qytetarëve. Mbikëqyrja inspektuese u është bërë tregjeve javore e sidomos rreth therries së kafshëve. Poashtu janë shqiptuar edhe gjoba mandatore. Poashtu nga Inspektori i ambientit janë inspektuar të gjitha pikat e shfrytëzimit të zhavorit si dhe gjendja e tyre, ku është konstatuar se në disa pika të shfrytëzimit të zhavorit kanë mbetur disa gropa ku është grumbulluar uji e që paraqet rrezik, sidomos për fëmijët. Për këtë kërkohet urgjentisht që të mirren masa dhe të mbyllen këto gropa.

Nga lemia e Inspektorit të ndërtimit në vazhdimësi janë bërë inspektime rreth ndërtimit, ku përpos procesverbaleve, janë hartuar edhe aktvendime për pezullim të punimeve, kufizime me shënja zyrtare, aktvendime për rrenime, kallëzime penale si dhe konkluzione për lejim të ekzekutimit e sidomos janë shqiptuar denime mandatore, ndërsa për ata që nuk kanë paguar, pagesat janë kryer përmes përmbaruesit privat, si dhe kërkesa për kundërvajtje në Gjykatën kompetente. Sidomos janë përcjellë ndërtimet sipas fazave të ndërtimit dhe janë lëshuar portofole për kryerjen në faza apo ato përfundimtare. Ndërsa ka pasur një rrënim të një objekti në Lagjen e Re në Komoran. Edhe shfrytëzuesit e hapësirave publike (terasave verore) është arritur që të lidhin kontrata në DUPMM dhe të bëjnë pagesën për shfrytëzimin e hapësirave publike. Për këtë periudhë raportuese nga Inspektori i Ndërtimit përpos procesverbaleve, janë lëshuar Aktvendime për pezullimin e punimeve 21, rrënimin e objekteve 03, portokolle të inspektimit 04, gjopa mandatore 35 vlera e tyre 8.500,00 euro, të paguara 7.100,00 euro 12 prej tyre përmes Përmbaruesit Privat. Poashtu janë përcjellë lëndë për Gjykatë për veper kundërvajtëse 15 lëndë, varësisht prej vepres, denimet prej 500,00-5.000,00 euro që pritet të ekzekutohen nga Gjykata.

Pasqyrëza e punës në teren për periudhën Janar- Qershor 2016:

Nr.	L. Inspektuse	Proc.	Aktvend	Pelq.	Akt. Per rren	Fletëp	Denime mand	Kërkesa	Tjera
1.	I. Tregut	148	18	07	-	-	-	08	-
2.	I. Ndërtimit	147	21	-	03	15	35	16	04 Ankesa
3.	I. Sanitar	58	06	06				06	Asgj. malli 238.20 €
4.	I. Komunika.	79	-	-	-	38	-		21 konf automj.+38kon f. Libre
5.	I. Ambientit	30	-	-	-		07	21	-
6.	I. Financiar	65	-	-	-	-	-	-	-
Totali:		527	45	13	03	53	42	51	63 238,20

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE -

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar – Qershor 2016 për realizimin e prioritetëve.	Performanca kyçe gjatë 6 mujorit të parë 2016
Synimi i rritjes për 5% nga planifikimi i fëmijëve që vaksinohen (nga 95%-2011 në 96.24%-2016).	- Vaksinimi i fëmijëve (gjashtë mujori)2016: - Të vaksinuar/rivaksinuar 6040 fëmijë/nxënës: - 12223 doza vaksinash (të vaksinuar). - Vaksinimi bëhet sipas orarit obligativ të përcaktuar nga IKSHP.
Zvoglimi i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë të posalindurve dhe nënave (maternale,para, gjatë dhe pas lindjes) në Maternitet	- Raporti 6 mujor 2016 për Maternitet: - 86 lindje - Të posalindur Femra: 44 - Të posalindur Mashkuj: 42 - Të posalindur të vdekur: 0 - Vdekje të nënave gjatë lindjes: 0

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar – Qershor 2016 për realizimin e prioritetëve.	Performanca kyçe gjatë 6 mujorit të parë 2016
Zvoglimi i numrit të personave me kujdes të veçantë - tretman rehabilitues-shërues (Koordinim Institucional DSHMS, QKMF dhe OJQ Handikos - sit).	- Në kontunuitet bëhet identifikimi i personave përmes , Handikosit, Qendrës për punë Sociale si dhe Qendrës për shëndet Mendorë bazuar në bashkësi. - Koordinimi i mirë veprimeve DSHMS me këto Institucione, në këtë 6 mujor 2016 Handikosi është ndihmuar me: 5000€, pagesë të qirasë 1 rastë 500€uro si dhe dhjetë raste trajtim/rehabilitim mjekësore 2635€ dhe Shoqata e të Shurdhërve me 200 €uro, si dhe furnizimi me miell për skamnor (obligim i mbetur nga viti paraprak) me vlerë 1900 €uro. - mbi 1150 persona me aftësi të kufizuara - 38 fëmijë rehabilitohen qendër / Handikos Drenas - mbi 1150 raste rehabilitohen, furnizohen material të nevojshëm ortopedik dhe shëndetësorë në shtëpi.
*Përmirësimi i shërbimeve emergjente, Lab, Rtg, Maternitet me paisjet dhe aparatura mjekësore diagnostifikim / shërim. *Menaxhimi i situatës Epidemiologjike dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse *Zvoglimi i incidencës së sëmundjeve kardiovaskulare, HIV/AIDS dhe TBC	- Plotësim dhe përmirësimi i resurseve humane të shërbimit me një punëtorë për mirëmbajtje(me afat të caktuar) si dhe vazhdon projekti në bashkëfinancim Komuna me Caritas Kosova për të sëmure me nevoja të veçanta (projekt bashkëfinancimi 70+30%). Gjithashtu projekti Marrëveshje Bashkëpunimi "Përkujdesje për shëndetin oral-stomatologjik për persona me gjendje të rëndë ekonomike-sociale" me Team Albania organizat nga Norvegjia - Situatë e qetë epidemiologjike gjatë 6 mujorit të parë të 2016. - Këshilla dhe ligjërata lidhur me edukimin shëndetësorë për të zvogluar konsumimin e kripës, yndyrës, sheqerit dhe duhanit etj. Puna me grupe të rrezikuara brenda QKMF-së dhe në teren. Ligjerata për adoleshent lidhur me edukimin shëndetësor (drogat , pirja duhanit, masat kontraceptive etj.)
*Përmirësimi i procedurave për qasje në mirëqenjen sociale, qartësimi i kriterëve, përmirësimi i zbulimit të mashtrimit. Rastet e SNS.	- Shtimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm, bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Agjencionin Tatimorë të Kosovës si dhe personat shfrytëzues të Skemës Ndihmës Sociale : Gjithsej raste në Skemën Sociale për 6 mujorin e parë 1339 raste / Janar- Qershor 2016.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI E SPORT-

Aktivitetet kryesore në 6-mujorin e parë janar-qershor 2016	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë 6 muajve (janar-qershor) / 2016
Aktivitetet kulturore	▪ U bë hartimi i plan – programit të punës për vitin 2016. ▪ U mbajtë manifestimi për 17 shkurtin ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku u mbajtë një Seancë Festive, u dha një program kulturo-arstistik me këngë e valle nga SHKA „Shotë Galica” . ▪ Me 28 shkurt 2016 në Drenas u mbajtë Akademi Përkujtimore dhe një program kulturor me rastin e 18 vjetorit të betejës së Likoshanit dhe Qirezit. ▪ Manifestimi letrar „Sofra poetike Ymer Elshani 2016” u mbajtë me 14 prill 2016 orë letrare në Gjimnazin „Gjergj kastroti Skenderbeu” dhe me 15 prill konkursi letrar me fillim në ora 11⁰⁰ në sallën e restaurantit „Diamant” në Drenas në praninë e shumë adhuresve të fjalës së shkruar.

	Pjesëmarrja ishte e shkelqyeshme nga të gjitha viset e Kosovës dhe nga trevat tjera ku jetojnë shqiptarët. - U organizua Manifestimi për Ditën e Çlirimit të Drenasit me 14 qershor ku u mbajtë koncert I madhë ku morën pjesë ansamli I këngëve dhe valleve, „Lidhja e Prizrenit” nga Prizreni, AGV „Karshiaka” nga Shkupi, SHKA „Shotë Galica” dhe këngëtar tjerë të ftuar. Me një monolog u paraqit aktori Basri Lushtaku. - Arkivi komunal punën e ka kryer në bazë të planit –programit të vet ku gjatë kësaj kohe janë lëshuar 7 çertifikata shkollre, 1 vërtetim, 1 palë për punim shkencor, 3 palë janë shërbye me dokumente afariste dhe 70 dokumente janë skanuar - Biblioteka në Drenas gjatë kësaj periudhe ka regjistruar 225 anëtar të rinjë dhe ka dhënë në lexim 900 libra. Ka gjithësejt 900 lexues të rregullt. Biblioteka është pasuruar me 500 ekzemplar të rinjë projekt i bërë nga DKRS dhe e financuar nga Minsitria e Kulturës, ndërsa ka marrë dhurtaë 70 ekzemplarë. Bibloteka në Arllat ka një fond prej 4887 ekzemplarësh, lexues të moshave të ndryshme ka gjithësejt 376 lexues, lexues të rinjë 48, ka dhënë në lexim 2256 libra. Bibloteka në Tërsetnik ka një fond prej 4000 ekzemplarësh, ka regjistruar 102 anëtar të rinjë, ka dhënë në lexim 870 libra. Ka gjithësejt 365 lexues. - SHKA „Shotë Galica” gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në këto festivale: „Flaka e Janarit” Gjilan; „Lulkuqet e prillit” Kamenicë; „Anadrinia jehon” Dejë; „Hasi Jehon” Gjonaj; „Tingujt e zemrës” Fushë Arrëz; „I këndojmë lirisë” Klinë; „Shkupi 2016” Shkup; „Burimet e Sharrit 2015” Tetovë; ku nga të gjitha këto festivale u kthyer me shperblime. - Gjatë periudhës janar-qershor Sektori i Kulturës me rastin e përvjetorëve të dëshmorëve, festave të shkollave fillore, turnireve të ndryshme sportive, akademive, shfaqjeve, koncerteve, bëri dekorimin dhe mbajti zërimin në të gjitha tubimet që u mbajtën në komunën e Drenasit
Aktivitetet sportive	- U mbajtë turnir në futboll të vogël me institucionet komunale me rastin e ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. - Me rastin e 28 shkurtit Betejës së Likoshanit-Qirezit u mbajtë turnir në futboll të vogël, turnir në futboll të madh dhe turnir në voleyboll femrat. - U mbajtë krosi komunal pranëveror ku morën pjesë 19 shkolla fillore dhe dy të mesme. - U mbatën garat e shkollave fillore ne futboll, hendboll (M&F) dhe voleyboll(M&F) ku morën pjesë 28 shkolla fillore. Në plasman të përgjithshëm vendin e parë e zuri SH.F.M.U „Rasim Kiqina” Drenas. - Turniri në futboll të vogël „ Rasim Kiqina ” u mbajtë nga data 30 maj deri me 14 qershor 2016 ku morën pjesë 95 ekipe nga e gjithë Kosova. Këtë vit ky turnir u mbajtë nën patronatin e Kryetarit të Komunës Z. Nexhat Demakut. Vendin e parë e zuri KF „Pëllumbi” Negroc-Drenas. - U ndihmuan financiarisht të gjitha klubet varsishtë nga kategoria dhe suksesi.Shumë ndeshje u përcollën nga Sektori i Sportit. - Këtë vit KF „Feronikeli” u shpall kampion i Kosovës. - FC „Feniksi” u bë kampion i Kosovës në futsal dhe merrë pjesë në ligën e kampionëve. - Në garat në nivel të Kosovës të cilat u organizuan në bashkëpunim me shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike u arriten këto rezultate:vendin e parë në hendboll mashkujt ekipi i gjimnazit „Skenderbeu” dhe në të gjitha garat Republikane kanë treguar rezultatet të kënaqshme.
Aktivitetet rinore	- U mbajtën takime me OJQ-të rinore - U mbajtë një mbrëmje muzikore për nder të ditës së Çlirimit të Drenasit. - U përgadit dhe doli Revista „Realiteti” me rastin e 14 qershorit ditës së çlirimit të Drenasit



KRYETARI I KOMUNËS

NEXHAT DEMAKU